



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 138/1 prot.

Tiranë, më 07/02/2024

**Agjencisë së Prokurimit Publik**

**Buletini i Njoftimeve Publike**

**Tiranë**

**Lënda:** Botim Njoftimi punësimi.

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 1 (një) vënd të lirë pune për punonjës administrate si më poshtë:

## **I. SEKTORI MËSIMOR**

### **- Specialist NJSBC - 1**

1. Kandidati për pozicionin e lirë të punës së **Specialistit NJSBC (Sektori Mësimor)**, duhet të plotësojë këto kritere:
  - 1.1 Të ketë kryer arsimin e lartë (master i shkencave/Bachelor), mesatarja e përgjithshme e notave mbi 7.5). Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar nga MAS.;
  - 1.2. Të ketë minimumi 3(tre) vjet eksperiencë pune në fushën (për të cilin është hapur ky pozicion pune), në institucone publike ose private që janë të lidhura ngushtë me arsimin, komuikimin apo menaxhimin;
  - 1.3. Të zotërojë njohuri të gjuhëve të programimit, të metodave të përpunimit statistikor si dhe të menaxhimit të bazave të të dhënave;

- 1.4. Të zotërojë me dëshmi njohuri të avancuara profesionale të paketës microsoft office;
- 1.5. Të ketë aftësi të plota për të vepruar;
- 1.6. Të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;
- 1.7. Të ketë vlerësime pozitive pune nga punëdhënësi i fundit;
- 1.8. Të jetë në kushte të shëndetshme që e lejojnë të kryejë detyrën;
- 1.9. Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, raportuese dhe të dijë të komunikojë në grup, në zbatim të Kodit të Etikës;
- 1.10. Të ketë dëshmi të një nga gjuhët ndërkombëtare (anglisht, frengjisht, spanjisht, italisht, gjermanisht);
- 1.11. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere nga Gjykata, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;

**Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit, duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:**

- 1.1. Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkurren;
- 1.2. Diplomë origjinale + listë notash/ fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë shtetit, njehsimi nga MAS);
- 1.3. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit europass, i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
  - 1.3.1. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnime, kualifikime, arsim shtesë apo të tjera përmendur në CV;
- 1.4. Të ketë aftësi të plota për të vepruar;
- 1.5. Dokument (fotokopje e librezës së punës), që vërteton përvojën në punë;
- 1.6. Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- 1.7. Dëshmi e gjuhës së huaj;
- 1.8. Kopje e letër njoftimit ose kartës së identitetit;
- 1.9. Çertifikatë familjare/personale;
- 1.10. Dëshmi e gjendjes gjyqësore/Vetëdeklarim;
- 1.11. Dëshmi e gjendjes mjekësore;

Konkurrimi do të bazohet në plotësimin e kriterëve profesionale të rektoratit dhe njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL, Kodin e Punës në RSH” dhe çdo akt ligjor e nënligjor që mbështet kryerjen e detyrës për këtë pozicion., Statutin e Universitetit të Arteve...etj.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në UART, duke filluar nga data **12.02.2024** deri më datë **26.02.2024** ora **14.00**.

Për datën e konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Rektoratin e Universitetit të Arteve, çdo ditë nga ora **08.00** deri në orën **14.00**.

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

---

**REKTOR**  
**UNIVERSITETI I ARTEVE**